



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.594/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues dhe Faton Ademi dhe Rustem Thaqi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Valmire Kuqi me vendbanim në Zvicër, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me ndërrimin e vendbanimit në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.09.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**HUDHET** i palejuar apeli Anr.594 /2021, i paraqitur nga Valmire Kuqi me vendbanim në Zvicër, me të cilin kërkon ndërrimin e vendbanimit në listën e votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

## A r s y e t i m

Me datën 01.09.2021 PZAP-i, ka pranuar një apel nga Valmire Kuqi me vendbanim në Zvicër, në të cilën pretendohet se ka aplikuar, për regjistrim si votues jashtë Kosove, me vendbanim në Komunën e Junikut dhe se në listën e publikuar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, emri i figuron në listë si votuese jashtë Kosovës për Komunën e Rahovecit, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më 17 Tetor 2021.

Parashtruesja e apelit, ka bashkangjitur formularin e aplikimit, kopjen e dokumentit identifikues/letërnjoftimin si dhe Ekstraktin nga Regjistri Qendror i gjendjes Civile.

Me datë 01.09.2021 PZAP ka parashtruar kërkesë për përgjigje në KQZ, me të cilën ka kërkuar që të njoftohet lidhur me apelin e parashtruar nga pala ankuese, KQZ brenda afatit kohor është përgjigje në kërkesë në të cilën ka theksuar se parashtruesja e apelit në dokumentin identifikues të Republikës së Kosovës që e ka dërguar bashkë me aplikacionin për regjistrim, mbiemrin e ka Valmire Kabashi, ndërsa në aplikacionin për regjistrim i ka dhënë të dhënat Valmire Kuqi.

Pra, me gjasë mbiemrin Kuqi, e ka mbiemrin e bashkëshortit, ndërsa mbiemri Kabashi është e dhënë nga letërnjoftimi i Republikës së Kosovës.

Më tej në përgjigje theksohet se Valmire Kuqi (Valmire Kabashi) është në listën e votuesve jashtë Kosovës, me numër të regjistrimit 2021171001538, në faqen numër 306 të Listës së Votuesve jashtë Kosovës që është e publikuar në ueb faqen e KQZ-së.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimit e apelimit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

### **Parashtruesit të Apelit i mungon interesi juridik**

Me datë 01.09.2021 Valmire Kuqi (Valmire Kabashi) në PZAP, ka parashtruar një apel ndaj KQZ-së, me të cilin kërkon ndërrimin e vendbanimit në listën e votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

PZAP ankesën e ankuesit e trajton si apel meqenëse ndaj vendimeve të KQZ-së, palët e interesuar mund të parashtrojnë Apel.

Me rastin e shqyrtimit të Apelit PZAP iu ka drejtuar KQZ-së, për të dhënë përgjigje në raport me apelin e parashtruesit dhe pretendimeve që dalin nga i njëjti. KQZ-ja, me anë të përgjigjes në apel dërguar në PZAP ka konfirmuar se parashtruesi i apelit gjendet në listën e votuesve meqenëse i njëjti i plotëson kushtet për tu përfshirë në listë, me numër të regjistrimit 2021171001538, në faqen numër 306 të Listës së Votuesve jashtë Kosovës që është e publikuar në ueb faqen e KQZ-së.

PZAP, duke vlerësuar apelin e personit në fjalë vlerëson se në rastin konkret të njëjtit i mungon interesi juridik për parashtrimin e apelit meqenëse i njëjti është i përfshirë në listën e votuesve. Andaj PZAP-i, konstaton se apeli i parashtruar është pa interes juridik pasi Valmire Kuqi (Valmire Kabashi) gjendet në listën votuese.

Prandaj PZAP-i, mbi këtë baze dhe nga arsyet e sipërhënuar dhe në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.594/2021 më datën 02.09.2021

**Kryesuesi i Panelit**

Adnan Konushevc

***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.